



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 38, datë 09. 10. 2012

**PËR**

**“RIORGANIZIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË QENDRES EKONOMIKE  
TË ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE ”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 32 shkronja “ç” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, (i ndryshuar); nenit 111, nenit 113, nenit 121, pika 1, nenit 124, pika 1, nenit 125, nenit 126, pika 1 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 për “Rregullat e Etikës në Administratën Publike”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.7, datë 30.03.2009 për “Organizimin e strukturave organizative dhe nivelin e pagave të disa ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë së Tiranës (i ndryshuar), sipas relacionit të paraqitur nga Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I**

1. Të miratojë riorganizimin e strukturës organizative të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve sipas organigramës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Efektet financiare për paga në shumën 1 400 000 lekë dhe sigurime shoqërore në shumën prej 234 000 leke do të përballohen nga fondi i miratuar respektivisht në këto zëra, në buxhetin e vitit 2012 për Qendrën Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.
3. Pika 1, shkronja “d” e vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 21, datë 10.11.2011, për “Riorganizimin e strukturës organizative të disa ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë së Tiranës”, revokohet.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Drejtoria e Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.
5. Ky vendim hyn në fuqi më 1 Nëntor të vitit 2012.

**K R Y E T A R I**

**Niazi KOSOVRASTI**